

OPERATORI I SHPERNDARJES SE ENERGIJE ELEKTRIKE
FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Per Operatorin Ekonomik: “Albanian Digital Printing Solutions & Services” sh.p.k, me adresë, Rr.“Cerciz Topulli”, Objekti nr.17, kodi postar 1051, Kashar, Tiranë, me NIPT L11518003F.

Numri i referencës së procedurës: **REF-70207-05-21-2018**

Procedura e prokurimit: *(E hapur –sherbime) me mjete elektronike*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Printim i faturës dhe zarfimi në versionin Selfmailer të OSHEE sh.a”** me fondi limit: **57,704,400** (pesëdhjetë e shtatë milion e shtatëqind e katër mijë e katërqind) lekë pa TVSH dhe me afat realizimi të kontratës 12 muaj nga nënshkrimi i kontratës.

Publikime të mëparshe: *nuk ka patur*

Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 21 date 28.05.2018.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X,

Njoftojme se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. OE: **“Albanian Digital Printing Solutions & Services” sh.p.k** me NIPT L11518003F, me vlerë oferte **44,460,000** (dyzet e kater milion e katerqind e gjashtedhjetë mijë) lekë pa TVSH.
2. OE **“Kristalina-KH” shpk** me NIPT K11501002D, me vlerë oferte **46,800,000** (dyzet e gjashtë milion e teteqind mijë) lekë pa TVSH.
3. OE: **“ADEL CO” sh.p.k** me NIPT L22117021M me vlerë oferte **52,852,800** (pesedhjetë e dy milion e teteqind e pesedhjetë e dy mijë) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

- OE **“Kristalina-KH” sh.p.k** per arsyet e me poshtme :
 - a) OE nuk paraqet dokumentacion provues sipas shtojces 8 “Kriteret e Vecanta te Kualifikimit” pika 3.3/8 “Kapaciteti Teknik” me ane te te cilit duhet vertetoje se disponon nje soft menaxhimi dhe monitorimi te punes (printimit dhe zarfimit te faturave) ne kohe reale.
 - b) OE nuk paraqet certificate te vlefshme sipas standartit ISO 27001, për sistemin e sigurisë së informacionit.
 - c) 10 mostrat e paraqitura ne permbushje te kerkesave te DST nuk jane sipas specifikimeve teknike te kerkuara. Konkretisht mungojne:
 - Dy linja perforimi përgjate gjatësisë së faturës për hapjen e zarfit si edhe instruksionet përkatëse për hapjen e zarfit. Ngjitje nga krahët anësore. Perforim horizontal tek linja e treguar.
 - Cdo faturë, në pjesën anësore mbrapa duhet të ketë numrin serial të lotit te fileve, numeratorin (counter) për kabinë, numrin e kabinës, qytetin dhe zonën.
 - “Shuma e detyrimit me ngjyra dhe ndryshon nga kopja në kopje ndërsa pjesa tjetër e tekstit bardhë e zi”.
 - Letra e perdorur nuk eshte Letër A4 90 gr/m2 later Bond.

Ne zbatim te nenit 53 të ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik” (i ndryshuar), eshte skualifikuar operatorin ekonomik **“Kristalina –KH” sh.p.k.**

* * *

Duke i’u referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë shoqerine **“Albanian Digital Printing Solutions & Services” sh.p.k**, me adresë, Rr. “Cerciz Topulli”, Objekti nr.17, kodi postar 1051,

kashar, Tiranë, me NIPT L11518003F, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **44,460,000** (dyzet e kater milion e katerqind e gjashtedhjetë mije) leke pa TVSH. Pikët totale të marra (100) është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë OSHEE sh.a me adrese: **OSHEE sh.a me adrese: Bulevardi “Gjergj Fishta”, Ndërtesa Nr. 88, H.1, Njësia Administrative Nr. 7, 1023, Tirana**, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe do të procedohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 03.09.2018

Ankesa ka patur: shte paraqitur ankesë nga shoqëria “Adel CO” sh.p.k, rregjistruar me Nr. 17184 Prot., datë 10.09.2018.

Me shkresën Nr. 17184/3 prot, datë 14.09.2018 i është kthyer përgjigje shoqërisë “Adel CO” sh.p.k ku i është komunikuar se ankesa nuk është pranuar.

Ne datën 24.09.2018 operatori ekonomik “Adel CO” sh.p.k ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik.

Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin 828/2018 datë 07.12.2018 ka vendosur :

1. Te perfundoje procedimin administrativ per proceduren e prokurimit “Procedure e Hapur” me Nr **REF-70207-05-21-2018** me objekt **“Printim i faturës dhe zarfimi në versionin Selfmailer të OSHEE sh.a”** me fondi limit: **57,704,400** (pesëdhjetë e shtatë milion e shtatëqind e katër mijë e katërqind) lekë pa tvsh, e zhvilluar ne datën 31.08.2018 nga autoriteti kontraktor OSHEE sh.a.

□